

L I G J

Nr.8483, date 10.5.1999

PER ADERIMIN E REPUBLIKES SE SHQIPERISE NE "KONVENTEN NDERKOMBETARE TE MBROJTJES SE BIMEVE"

Ne mbeshtetje te neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te Ministrave

K U V E N D I

I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqiperise aderon ne "Konventen Nderkombetare te Mbrojtjes se Bimeve".

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2372, date 20.5.1999 te Presidentit te Republikes se Shqiperise, Rexhep Meidani

TEKSTI I RI I RISHIKUAR

I KONVENTES NDERKOMBETARE TE MBROJTJES SE BIMEVE

PARATHENIE

Palet kontraktuese,

- duke pranuar nevojën për kooperim ndërkombëtar në mbajtjen nën kontroll të parazitëve të bimëve dhe produkteve bimërore dhe në parandalimin e përhapjes së tyre në shkallë ndërkombëtare, dhe veçanërisht hyrjen e tyre në zona të rrezikuara;

- duke pranuar qe masat fitosanitare duhet te jene teknikisht te justifikuara, transparente dhe nuk duhet te aplikohen ne menyre te tille qe per me teper te perbejne nje menyre arbitrare ose nje diskriminim te pajustificuar ose nje kufizim te maskuar, veçanerisht per tregtine nderkombetare;

- duke deshruar te sigurojne koordinim te ngushte te masave qe kane te bejne me keto perfundime;

- duke dashur te sigurojne nje kuader per zhvillimin dhe aplikimin e masave fitosanitare te harmonizuara dhe perpunimin e standardeve nderkombetare per kete qellim; dhe

- duke mbajtur parasysh principet e miratuara nderkombetarisht ne drejtim te mbrojtjes se bimeve, shendetit te kafsheve dhe te njerezve dhe te mjedisit;

- duke pare Marreveshjet e konkluduara si rezultat i Negociatave te Uruguajit per Tregtine Shumepaleshe, perfshire Marreveshjen mbi Zbatimin e Masave Sanitare dhe Fitosanitare;

rane dakord si vijon:

NENI I

Qellimi dhe pergjegjesia

1. Me qellimin qe te sigurojne veprime te perbashketa dhe efektive per te parandaluar perhapjen dhe hyrjen e parazitëve te bimeve dhe produkteve bimore, dhe per te nxitur masa te pershtatshme per luftimin e tyre, palet kontraktuese marrin persiper te adaptojne masat legjislative, teknike dhe administrative te specifikuara ne kete Konvente dhe ne Marreveshjet suplementare ne perputhje me Nenin XVI.

2. ?do pale kontraktuese do te marre persiper pergjegjesine, pa paragjykuar per detyrimet e marra persiper nga Marreveshje te tjera nderkombetare, per plotesimin brenda territoreve te tyre te te gjithë kerkesave te kesaj Konvente.

3. Ndarja e pergjegjesive per plotesimin e kerkesave te kesaj Konvente midis Organizatave Anetare te FAO dhe shteteve anetare te tyre qe jane pale kontraktuese, do te jete ne perputhje me kompetencat perkatese te tyre.

4. Ku eshte e nevojshme, parashikimet e kesaj Konvente mund te gjykohen nga palet kontraktuese per t'u zgjeruar, ne lidhje me bimet dhe produktet bimore, vendet e ruajtjes, ambalazhet, mjetet e transportit, konteineret, token dhe Ødo objekt tjeter, organizem ose material te pershtatshem per strehimin ose shperndarjen e parazitëve te bimeve, veçanerisht ku transporti nderkombetar eshte i pranishem.

NENI II

Perdorimi i termave

1. Per qellimin e kesaj Konvente, termat qe vijojne do te kene kuptimin e percaktuar si me poshte per to:

"Zone me prezence te paket te parazitit" - nje zone, apo gjithë nje shtet, pjese e nje shteti, ose gjithë ose pjese te disa shteteve, siØ eshte identifikuar nga autoritetet kompetente, ne te cilat nje parazit specifik ndeshet ne nje nivel te ulet dhe qe eshte subjekt per vrojtim efektiv, mbajtur nen kontroll ose masa Ørrenjose;

"Komision" - Komisioni i Masave Fitosanitare i percaktuar ne nenin XI;

"Zone e rrezikuar" - nje zone ku faktoret ekologjike favorizojne vendosjen e nje paraziti prezenca e te cilit ne zone do te rezultojte me humbje ekonomike te ndjeshme;

"Vendosje" - perjetesim, per te ardhmen e parashikuar, i nje paraziti brenda nje zone pas hyrjes;

"Masa fitosanitare te harmonizuara" - masa fitosanitare te vendosura nga palet kontraktuese te bazuara ne standardet nderkombetare;

"Standarde nderkombetare" - standarde nderkombetare te vendosura ne perputhje me nenin X, parag. 1 dhe 2;

"Hyrje" - hyrja e nje paraziti qe rezulton me vendosjen e tij.

"Pest" - Ødo specie, shtam ose biotip i bimeve, kafshe ose agjent patogjen i demshem per bimet dhe produktet bimore;

"Analiza rrezikut te parazitit" - procesi i vleresimit biologjik ose evidentim tjetër shkencor dhe ekonomik per te percaktuar nese nje parazit mund te jete i kontrolluar dhe forcimi i masave fitosanitare qe duhen marre kunder tij;

"Masa fitosanitare" - Ødo legjislacion, rregullore ose procedure zyrtare qe ka per qellim te parandalojte hyrjen/ose shperndarjen e paraziteve;

"Bime" - bimet e gjalla dhe pjeset e tyre, perfshire farat dhe germoplazmen;

"Produkte bimore" - materiale te paperpunuar me origjine bimore (perfshi kokrrat) dhe ato produkte te perpunuara qe, nga natyra e tyre qe, ose prej perpunimit te tyre, mund te krijojne rrezik per hyrjen dhe perhapjen e paraziteve;

"Parazite karantinore" - nje parazit me rendesi potenciale ekonomike per zonen te rrezikuar prej tij dhe jo prezent aty akoma, ose prezent por jo gjeresisht i perhapur dhe qe eshte zyrtarisht i kontrolluar;

"Standarde rajonale" - standarde te vendosura nga nje organizate rajonale e mbrojtjes se bimeve per udhezimin e anetareve te kesaj organizate;

"Artikuj te kontrollueshem" - Ødo bime, produkt bimor, vend ruajtje, ambalazh, mjet transporti, container, token ose organizem tjetër, objekt ose material i afte per strehimin dhe perhapjen e paraziteve, qe gjykohet se kerkon masa fitosanitare, veØanerisht ne transportin nderkombetar eshte i pranishem;

"Parazite jo karantinore te kontrollueshem" - nje parazit jo karantinor prezenca e te cilit ne bimet per mbjellje influencen perdorimin e parashikuar te ketyre bimeve me nje ndikim te papranueshem ekonomik, i cili eshte kontrolluar brenda territorit te pales kontraktuese importuese;

"Parazit i kontrollueshem" - nje parazit karantinor dhe /ose nje parazit jo karantinor i kontrollueshem;

"Sekretari" - sekretaria e Komisionit te percaktuar ne perputhje me Nenin XII;

"I justifikuar teknikisht" - I justifikuar mbi bazen e konkluzioneve te arritura nga perdorimi i nje analize te duhur per rrezikun e parazitit ose, ku eshte i zbatueshem, nje tjetër ekzaminim i krahasueshem dhe informacion shkencor i vlefshem;

2. Percaktimi i katert ne kete nen, duke qene i kufizuar ne zbatimin e kesaj Konvente, nuk do te gjykohet per te ndikuar percaktimet e vendosura ne ligjet ose rregulloret kombetare te paleve kontraktuese.

Marredheniet me marreveshjet e tjera nderkombetare

Asgje ne kete Konvente nuk do te ndikojte te drejttat dhe detyrimet e Paleve Kontraktuese, qe rrjedhin nga marreveshjet nderkombetare ekzistuese.

NENI IV

Parashikime te pergjithshme lidhur me rregullat organizative per mbrojtjen kombetare te bimeve

1. ?do pale kontraktuese do te beje parashikimin, me kompetencat e saj me te plota, per nje organizate zyrtare, kombetare te mbrojtjes se bimeve me pergjegjesite kryesore te deklaruar ne kete nen.

2. Pergjegjesite e nje organizate zyrtare, kombetare te mbrojtjes se bimeve do te perfshijne sa vijon:

(a) leshimin e certifikates sipas rregullores fitosanitare te paleve kontraktuese importuese per ngarkesat e bimeve dhe produkteve bimore dhe artikujve te tjere te kontrollueshem;

(b) vrojtimin e bimeve gjate vegjetacionit, perfshire siperfaqen e kultivuar dhe (inter alia fields, plantacionet, fidanishtet, kopshtet, serat dhe labororet) dhe floren e pakultivuar, bimet dhe produktet bimore ne ruajtje, ose ne transport me objekt raportimin e prezences, epidemite dhe perhapjen e paraziteve, dhe luftimin e ketyre paraziteve, perfshire raportimin sipas nenit VIII paragrafi 1a;

(c) inspektimi i ngarkesave te bimeve dhe produkteve bimore qe levizin ne trafikun nderkombetar, dhe, ku eshte e pershtatshme, inspektimin e artikujve te tjere te kontrollueshem, ve?anerisht me objekt parandalimin e futjes dhe/ose te perhapjes se paraziteve;

(d) dizinfektimi ose desinfestimi i ngarkesave te bimeve, produkteve bimore dhe artikujve te tjere te kontrollueshem qe levizin ne trafikun nderkombetar per te plotesuar kerkesat fitosanitare;

(e) mbrojtja e zonave te rrezikuara dhe percaktimi, ruajtja dhe vrojtimi i zonave te pa infektuara dhe e zonave me prezence te ulet te parazitit;

(f) drejtimi i analizes se rrezikut te parazitit;

(g) te siguroje permes procedurave te pershtatshme sigurimin fitosanitar te ngarkesave pas certifikimit per sa i perket organizimit, tregtimit dhe reinfestimit te ruajtura perpara eksportit; dhe

(h) kualifikimi i metejshem i stafit;

3. ?do pale kontraktuese do te beje parashikimin, me kompetencat e saj me te plota, per sa vijon :

(a) shperndarjen e informacionit brenda territorit te pales kontraktuese ne lidhje me parazitet dhe masat per parandalimin dhe luftimin e tyre;

(b) kerkime shkencore dhe investime ne fushen e mbrojtjes se bimeve;

(c) publikimin e rregulloreve fitosanitare; dhe

(d) kryerjen e funksioneve te tjera te tilla qe mund te nevojiten per venien ne jete te kesaj Konvente.

3. ?do Pale kontraktuese do t'i paraqese Sekretarise nje pershkrim te Organizates se saj Kombetare te Mbrojtjes se Bimeve dhe te riorganizimeve te kesaj organizate. Pala kontraktuese do te pergatise nje pershkrim per rregullat organizative te saj per mbrojtjen e bimeve per nje tjeter pale kontraktuese, kur kerkohet.

NENI V

Certifikata fitosanitare

1. ?do pale kontraktuese do te beje pergatitjen per certifikaten fitosanitare, me objektiv qe te siguroje se bimet, produktet bimore dhe artikuj te tjere te kontrollueshem dhe ngarkesat qe eksportohen jane ne perputhje me gjendjen e certifikueshme te percaktuar ne paragrafin 2 (b) te ketij neni.

2. ?do pale kontraktuese do te beje pergatitjet per leshimin e certifikates fitosanitare ne perputhje me parashikimet e meposhtme:

(a) Inspektimi dhe veprime te tjera qe lidhen me te per leshimin e certifikates fitosanitare do te behen vetem nga ose nen autoritetin e organizates zyrtare kombetare te mbrojtjes se bimeve. Leshimi i certifikates fitosanitare do te behet nga oficeret shteterore te cilet jane tekniksht te kualifikuar dhe te autorizuar ne kohen e duhur nga organizata zyrtare kombetare e mbrojtjes se bimeve per te vepruar ne emer te saj dhe nen kontrollin e saj me njohuri te tilla dhe informacion te mjaftueshem per keta oficeret ne menyre qe autoritetet e pales kontraktuese importuese te mund te pranojne certifikaten fitosanitare me konfidence si dokument te besueshem.

(b) Certifikatat fitosanitare, ose ekuivalentet e tyre elektronike te pranuar nga pala kontraktuese perkatese, do te jete siØ eshte formuluar ne modelet e shpallura ne Aneksin e kesaj Konvente. Keto certifikata duhet te plotesohen dhe te leshohen duke mbajtur parasysh standardet nderkombetare perkatese.

(c) Alternativat e paqarta ose fshirjet i bejne te pavlefshme certifikatat.

3. ?do pale kontraktuese merr persiper te mos lejoje importimin e ngarkesave te bimeve produkteve bimore ose te artikujve te tjere te kontrollueshem brenda territorit te tyre te shoqeruar me certifikate fitosanitare qe nuk perputhet me modet e shpallura ne Aneksin e kesaj Konvente. ?do kerkese per deklarime shtese do te jete e kufizuar per ato qe justifikohen tekniksht.

NENI VI

Parazite te kontrollueshem

1. Palet kontraktuese mund te kerkojne masa fitosanitare per parazitet karantinore dhe per parazitet jo karantinore te kontrollueshem, duke parashikuar qe keto masa te jene:

(a) jo me te rrepta se masat e aplikuara per te njejtet parazite, nese jane prezent ne territorin e pales kontraktuese importuese; dhe

(b) te kufizuara per cfar eshte e nevojshme per te mbrojtur shendetin e bimeve dhe/ose ruajtje qellimit te perdorimit dhe te mund te jene teknikisht te justifikuara nga palet kontraktuese perkatese.

2. Palet kontraktuese nuk do te kerkojne masa fitosanitare per parazitet jo te kontrollueshem.

NENI VII

Kerkesat ne lidhje me importet

1. Me qellim qe te parandalohet hyrja dhe/ose perhapja e paraziteve te kontrollueshem brenda territorit te tyre, palet kontraktuese do te kene autoritet te pavarur per te kontrolluar, ne perputhje me Marreveshjet nderkombetare perkatese, hyrjen e bimeve, produkteve bimore dhe artikujve te tjere te kontrollueshem, dhe per kete qellim, mundet :

(a) te paracaktone dhe te adoptojne masat fitosanitare ne lidhje me importimin e bimeve, produkteve bimore dhe artikujve te tjere te kontrollueshem perfshire psh inspektimin, ndalimin e importimit dhe trajtimin;

(b) te refuzojne hyrjen apo te pengojne ose te kerkojne trajtim, shkaterrim ose rilevizje nga territori i pales kontraktuese te bimeve, produkteve bimore dhe artikujve te tjere te kontrollueshem ose ngarkesave qe nuk perputhen me masat fitosanitare te paracaktuara ose te pershtatura ne paragrafin e mesiperme (a);

(c) te ndalojne ose te kufizojne levizjen e paraziteve te kontrollueshem brenda territorit te tyre;

(d) te ndalojne ose kufizojne levizjen e agjenteve te kontrollit biologjik dhe organizmave te tjere qe kane te bejne me problemet fitosanitare me pretendimin qe te jene te dobishem brenda territorit te tyre.

2. Me qellim qe te minimizohen iterferencat me tregun nderkombetar, Ødo pale kontraktuese, ne ushtrimin e autoritetit te vet sipas paragrafit 1 te ketij neni, merr persiper per te vepruar ne perputhje me sa vijon:

(a) Palet kontraktuese, sipas legjislacionit te tyre fitosanitar, nuk do te marrin ndonje prej masave te specifikuara ne paragrafin 1 te ketij neni po te mos jene bere te nevojshme masa te tilla nga konsideratat fitosanitare dhe te jene teknikisht te justifikuara;

(b) palet kontraktuese, menjehere do te adoptojne, publikojne dhe transmetojne kerkesat fitosanitare, kufizimet dhe ndalimet e Ødo pale kontraktuese ose paleve kontraktuese qe ata besojne se direkt mundet te ndikohen nga masa te tilla;

(c) palet kontraktuese, sipas kerkeses, do te vene ne dispozicion per Ødo pale kontraktuese motivimin per kerkesat fitosanitare, kufizimet dhe ndalimet rationale;

(d) nese nje pale kontraktuese kerkon qe ngarkesat e veØanta te bimeve ose produkteve bimore te importohen vetem permes pikave te veØanta te hyrjes, keto pika do zgjidhen te tilla qe te mos pengojne pa qene nevoja tregtine nderkombetare. Palet kontraktuese do te publikojne nje liste te ketyre pikave te hyrjes dhe t'i komunikojne ato ne Sekretari, ne Ødo organizate rajonale te mbrojtjes se bimeve ne te cilen pala kontraktuese eshte anetare, te gjitha paleve kontraktuese per te cilat pala kontraktuese mendon se ndikohen direkt, dhe palet e tjera kontraktuese sipas kerkeses. Te tilla kufizime ne pikat e hyrjes nuk do te behen perveØ bimeve, produkteve bimore dhe

artikujve te tjere te kontrollueshem te cilet kerkohet te jene te shoqeruar me certifikate fitosanitare ose te jene paraqitur per inspektim ose trajtim;

(e) Ødo inspektim ose procedure tjeter fitosanitare e kerkuar nga organizata e mbrojtjes se bimeve e nje pale kontraktuese per nje ngarkese te bimeve, produkteve bimore ose artikulli tjeter te kontrollueshem te ofruar per importim do te kryhet aq shpejt sa te jete e mundur e lidhur kjo me qendrushmerine ndaj prishjes;

(f) palet importuese kontraktuese do te informojne sa me shpejt te jete e mundur, palen kontraktuese eksportuese perkatese ose, ku eshte e pershtatshme, palen kontraktuese rieksportuese lidhur me rastet e mosperputhjes me certifikaten fitosanitare. Palet eksportuese kontraktuese ose, ku eshte e pershtatshme, palet kontraktuese rieksportuese perkatese do te shqyrtojne dhe, sipas kerkeses, raportojne rezultatet e hetimeve te tyre pales kontraktuese importuese perkatese;

(g) palet kontraktuese do te ndermarrin vetem masat fitosanitare qe jane te justifikuara teknikisht, ne perputhje me rrezikun e parazitit perkates dhe paraqesin masat kufizuese me te pakta te duhura, dhe rezultojne ne pengesa minimale per levizjen nderkombetare te njerezve, mallrave dhe mjeteve te transportit;

(h) palet kontraktuese, nese kushtet ndryshojne, dhe nese fakte te reja behen te pershtatshme, do te sigurojne qe masat fitosanitare do te modifikohen menjehere ose eliminohen nese shihen si te panevojshme;

(i) palet kontraktuese, me kompetencat e tyre me te plota, fiksojne dhe permiresojne listen e paraziteve te kontrollueshem, duke perdorur emrat shkencore, dhe duke e bere kete liste te pershtatshme per Sekretarine, per organizatat rajonale te mbrojtjes se bimeve ne te cilat ato jane anetare, dhe sipas kerkeses, per palet e tjera kontraktuese.

(j) palet kontraktuese, me kompetencat e tyre me te plota, do te drejtojne vrojtimin per parazitet dhe do te marrin ne vazhdimesi dhe te mbajne informacionin e nevojshem mbi gjendjen e paraziteve me qellim qe te mbeshtesin kategorizimin e paraziteve, dhe per zbatimin e masave fitosanitare te pershtatshme. Ky informacion mund te jete i dobishem per palet kontraktuese, kur kerkohet.

3. Nje pale kontraktuese mund te zbatej masat e specifikuara ne kete nen per parazitet te cilet mund te mos jene te afte per t'u vendosur ne territoret e tyre, por nese ato hyjne me shumice, shkaktojne dem ekonomik. Masat e marra kunder ketyre paraziteve duhet te jene teknikisht te justifikuara.

4. Palet kontraktuese mund te aplikojne masat e specifikuara ne kete nen per ngarkesat ne tranzit permes territorit te tyre vetem kur te tilla masa jane teknikisht te justifikuara dhe te nevojshme per te parandaluar hyrjen dhe/ose perhapjen e paraziteve.

5. Asgje ne kete nen nuk do te parandaloje palet kontraktuese importuese per hartimin e parashikimeve te veØanta, qe kane subjekt mbrojtjen e nevojshme, per importimin, per qellimet e kerkimit shkencor, edukimit, ose perdorimeve te tjera specifike, per bimet produktet bimore dhe artikuj te tjere te kontrollueshem, dhe per parazitet e bimeve,

6. Asgje ne kete nen nuk do te parandaloje ndonje pale kontraktuese per marrjen e veprimeve emergjente te pershtatshme mbi zbulimin e nje demtuesi qe paraqet nje rrezik potencial per territoret e tij ose raportimin e nje zbulimi te tille. Ødo veprim i tille duhet te vleresohet sa me shpejt te jete e mundur per te siguruar qe vazhdimesia e tij te jete e justifikuar. Veprimi i ndermarre do t'i raportohet menjehere paleve kontraktuese

perkatese, Sekretarise dhe Ødo organizate rajonale te mbrojtjes se bimeve ne te cilen pala kontraktuese eshte anetare.

NENI VIII

Kooperimi nderkombetar

1. Palet kontraktuese do te kooperojne me nje tjetër sa me shume te jete e mundshme per arritjen e qellimeve te kesaj Konvente, dhe ne veØanti do te:
 - (a) kooperojne ne shkembimin e informacionit mbi parazitët e bimeve, veØanerisht raportimi i prezences, shperthimit ose perhapjes se parazitëve qe mund te jene menjehere ose potencialisht te rrezikshem, ne perputhje me procedura te tilla qe mund te jene vendosur nga Komisioni;
 - (b) marrin pjese, aqsa te jete e mundshme, ne Ødo fushate te veØante per luftimin e parazitëve, qe seriozisht mund te rrezikojne prodhimin bimor dhe ka nevojë per veprime nderkombetare per t'i bere balle emergjencave; dhe
 - (c) do te kooperojne, per zgjerim te mundshem, ne pergatitjen e informacionit teknik dhe biologjik te nevojshem per analizen e rrezikut te parazitëve. Ødo pale kontraktuese do te percaktoje nje pike takimi per shkembimin e informacionit lidhur me venien ne jete te kesaj Konvente.

NENI IX

Organizatate rajonale te mbrojtjes se bimeve

1. Palet kontraktuese marrin persiper te kooperojne me nje tjetër per krijimin e organizatave rajonale te mbrojtjes se bimeve ne zonat perkatese.
2. Organizatate rajonale te mbrojtjes se bimeve do te funksionojne si organizma koordinimi ne zonat qe mbulojne, do te marrin pjese ne veprimtari te ndryshme per te arritur objektivat e kesaj Konvente dhe, ku eshte e nevojshme, do te grumbullojne dhe shperndajne informacion.
3. Organizatate rajonale te mbrojtjes se bimeve do te kooperojne me Sekretarine per arritjen e objektiveve te Konventes dhe, ku eshte e nevojshme, kooperojne me Sekretarine dhe Komisionin per permiresimin e standardeve nderkombetare.
4. Sekretaria do te mbledhe Konsultimet Teknike periodike te perfaqesuesve te organizatave rajonale te mbrojtjes se bimeve per te:
 - (a) nxitur zhvillimin dhe perdorimin e standardeve nderkombetare perkatese per masat fitosanitare;
 - (b) inkurajuar kooperimin nderrajonal per nxitje te masave fitosanitare per kontrollin e parazitëve dhe per parandalimin e perhapjes dhe/ose hyrjes.

NENI X

Standardet

1. Palet kontraktuese bien dakord per te kooperuar ne vendosjen e standardeve nderkombetare ne perputhje me procedurat e miratuara nga Komisioni.
2. Standardet nderkombetare duhet te jene miratuar nga Komisioni.
3. Standardet rajonale duhet te jene ne perputhje me principet e kesaj Konvente; te tilla standarde mund te vendosen me Komisionin per t'u konsideruar si kandidatet per standardet nderkombetare per masat fitosanitare nese aplikohen me gjeresisht.
4. Palet kontraktuese duhet te marrin parasysh, siç duhet, standardet nderkombetare kur ndermarrin veprimtari qe kane te bejne me kete Konvente.

NENI XI

Komisioni mbi Masat Fitosanitare

1. Palet Kontraktuese bien dakord per te themeluar Komisionin mbi Masat Fitosanitare brenda kuadrit te Organizates per Bujqesine dhe Ushqimin te Kombeve te Bashkuara (FAO).
2. Funkzionet e Komisionit do te promovojne venien plotesisht ne jete te objektivave te Konventes dhe ne veçanti per te:
 - (a) rishikuar gjendjen e mbrojtjes se bimeve ne bote dhe nevojten per veprim per te kontrolluar shperndarjen nderkombetare te parazitëve dhe hyrjen e tyre brenda zonave te rrezikuara;
 - (b) vendosur dhe mbajtur nen kontroll, organizimet e nevojshme institucionale dhe procedurat per zhvillimin dhe adoptimin e standardeve nderkombetare, dhe per miratimin e standardeve nderkombetare;
 - (c) vendosur rregullat dhe procedurat per zgjidhjen e problemeve ne perputhje me nenin XIII;
 - (d) themeluar te tilla organizma ndimese te Komisionit qe mund te jene te pershtatshme per venien siç duhet ne jete te funksioneve te tij;
 - (e) shpallur udhezues per njohjen e organizatave rajonale te mbrojtjes se bimeve;
 - (f) vendosur kooperim me organizatat e tjera nderkombetare mbi çeshtje te trajtuara nga kjo Konvente;
 - (g) shpallur rekomandime per venien ne jete siç duhet te Konventes;
 - (h) kryer te tilla funksione te tjera qe mund te jene te nevojshme per plotesimin e objektivave te kesaj Konvente.
3. Anetaresimi ne Komision do te jete i hapur per te gjitha palet Kontraktuese.
4. ?do pale kontraktuese mund te perfaqesohet ne seksionet e Komisionit nga nje delegat i vetem i cili mund te jete i shoqeruar nga nje alternant, dhe nga eksperte e keshillues. Alternantet, ekspertet dhe keshilluesit mund te marrin pjese ne procedurat e Komisionit por nuk mund te votojne, me perjashtim te rasteve kur nje alternant eshte i autorizuar siç duhet per zevendesimin e delegatit.
5. Palet kontraktuese do te bejne çdo perpjekje per te arritur Marreveshjet mbi te gjitha çeshtjet me konsensus. Nese te gjitha perpjekjet per te arritur konsensus kane qene te pamundura dhe nuk eshte arritur ne asnje Marreveshje, vendimi do te merret si nje zgjedhje e fundit, nga dy te tretat e shumices se paleve kontraktuese prezent ne votim.
6. Nje organizate anetare e FAO-s qe eshte nje pale kontraktuese dhe shtetet anetare te kesaj organizate anetare qe jane palet kontraktuese, do te ushtrojne te drejtat e

anetaresimit te tyre dhe te plotesojne detyrimet e anetaresimit te tyre ne perputhje, mutatis mutandis, me Kushtetuten dhe Rregullat e Pergjithshme te FAO-s.

7. Komisioni mund te adoptoje dhe te shtoje, per sa kerkohet, Rregullat e tij te Procedimit, te cilat nuk duhet te jene ne mosperputhje me kete Konvente dhe me Kushtetuten e FAO-s.

8. Kryetari i Komisionit do te mbledhe nje sesion te rregullt vjetor te Komisionit.

9. Sesione te veçanta te Komisionit do te mblidhen nga Kryetari i Komisionit me kerkesen e te pakten nje te tretes se anetareve te tij.

10. Komisioni do te zgjedhe Kryetarin e tij dhe jo me shume se dy nenkryetare, Ødo njeri prej te cileve do te sherbeje per nje afat kohor prej dy vjetesh.

NENI XII

Sekretariati

1. Sekretaria e Komisionit do te zgjidhet nga Drejtori i Pergjithshem i FAO-s.

2. Sekretaria do te perbehet nga stafi i sekretariatit qe eshte i nevojshem.

3. Sekretaria do te jete pergjegjese per venien ne jete te politikave dhe veprimtarive te Komisionit dhe te kryej funksione te tjera qe jane caktuar per te nga kjo Konvente dhe do te raportoje mbi to ne Komision.

4. Sekretaria do te shperndaje:

(a) standardet nderkombetare te gjitha paleve kontraktuese brenda gjashte diteve prej miratimit;

(b) te gjitha paleve kontraktuese, listen e pikave te hyrjes sipas nenit VII, paragrafi 2(d) te komunikuar nga palet kontraktuese;

(c) listen e parazitëve te kontrollueshem hyrja e te cilave eshte e ndaluar ose ne perputhje me nenin VII, paragrafi 2 (i) per te gjitha palet kontraktuese dhe organizatat rajonale te mbrojtjes se bimeve;

(d) informacionin e marre nga palet kontraktuese mbi kerkesat fitosanitare, kufizimet dhe ndalimet sipas nenit VII 2b, dhe pershkrimin e organizatave te mbrojtjes se bimeve sipas nenit IV, paragrafi 4.

5. Sekretariati do te parashikojë perkthimin ne gjuhët zyrtare te FAO-s, te dokumentacionit per mbledhjet e Komisionit dhe te standardeve nderkombetare.

6. Sekretariati do te koepereje me organizatat rajonale te mbrojtjes se bimeve ne arritjen e qellimeve te Konventes.

NENI XIII

Zgjidhja e mosmarreshjeve

1. Nese ka ndonje mosmarreshje ne lidhje me interpretimin ose aplikimin e kesaj Konvente, ose nje pale kontraktuese konsideron se ndonje veprim i pales tjeter kontraktuese eshte ne kundërshtim me detyrimet e permendura ne nenin V dhe VII te kesaj Konvente, veçanerisht ne lidhje me bazat e ndalimit ose kufizimit te importit te bimeve, produkteve bimore ose artikujve te tjere te ardhur nga territoret e tyre, palet kontraktuese perkatese do te konsultohen mes tyre sa me shpejt te jete e mundur me synim per te zgjidhur mosmarreshjen.

2. Nese mosmarveshja nuk mund te zgjidhet nga sa u permend ne parag.1, pala kontraktuese mund t'i kerkoje Drejtorit te Pergjithshem te FAO-s te zgjedhe nje komitet ekspertesh lidhur me Øeshtjen ne diskutim, ne perputhje me rregullat dhe procedurat qe mund te jene vendosur nga Komisioni.
3. Komiteti do te perfshije perfaqesues te caktuar nga Ødo pale kontraktuese perkatese. Komiteti do ta konsideroje Øeshtjen ne diskutim, duke marre parasyshe te gjithë dokumentet dhe formularet e tjere te evidences te paraqitur nga palet kontraktuese perkatese. Komiteti do te pergatise nje raport mbi aspektet teknike te mosmarveshjes me qellim qe te kerkoje zgjidhjen e saj. Pergatitja e raportit dhe miratimi i tij do te jene ne perputhje me rregullat dhe procedurat e vendosura nga Komisioni, dhe ky do t'u transmetohet paleve kontraktuese perkatese nga Drejtori i Pergjithshem. Raporti, mundet gjithashtu t'i paraqitet, sipas kerkeses, organizmit kompetent te organizates nderkombetare pergjegjese per zgjidhjen e mosmarveshjeve tregtare.
4. Palet kontraktuese bien dakord qe rekomandimet e nje Komiteti te tille, jo detyruese ne karakter, do te behen bazat per konsiderate te re nga palet kontraktuese perkatese per Øeshtjen jashte te ciles mosmarveshja eshte ngritur.
5. Palet kontraktuese perkatese do te ndajne shpenzimet per ekspertet.
6. Parashikimet e ketij neni do te jene plotesuese dhe jo per te dobesuar procedurat e parashikuara per zgjidhjen e mosmarveshjeve ne marveshjet e tjera qe merren me Øeshtjet tregtare.

NENI XIV

Zevendesimi i marveshjeve te meparshme

Kjo Konvente do te perfundoje dhe zevendesoje, midis paleve kontraktuese, Konventen nderkombetare per marrjen e masave respektive kunder Phylloxera vastratix te 3 nentorit 1881, Konventen shtese te Bernes te 15 prillit 1889 dhe Konventen Nderkombetare per Mbrojtjen e Bimeve te miratuar me 16 prill 1929.

NENI XV

Aplikimi territorial

1. Ødo pale kontraktuese ne kohen e ratifikimit ose te anetaresimit ose me pas mund t'i komunikojë Drejtorit te Pergjithshem te FAO nje deklarate qe kjo Konvente do te shtrihet ne te gjithë ose ne ndonje prej territoreve per marredheniet nderkombetare per te cilat kjo eshte pergjegjese, dhe kjo Konvente do te aplikohet ne te gjithë territoret e specifikuar ne deklarate 30 dite pas firmosjes se deklarates nga Drejtori i Pergjithshem.
2. Ødo pale kontraktuese e cila i ka komunikuar Drejtorit te Pergjithshem te FAO-s nje deklarate ne perputhje me parag.1 te ketij Neni mundet ne Ødo kohe te komunikojë nje deklarim te metejshem duke modifikuar qellimin e Ødo deklarate te meparshme ose duke kufizuar zbatimin e parashikimeve te kesaj Konvente ne lidhje me Ødo territor.
3. Drejtori i Pergjithshem i FAO-s do te informoje te gjitha palet kontraktuese per Ødo deklarim te leshuar sipas ketij neni.

NENI XVI

Marreveshje suplementare

1. Palet kontraktuese, me qellim qe te perballojne probleme speciale te mbrojtjes se bimeve te cilat kerkojne vemendje ose veprim te veØante, mundet te hyjne ne Marreveshje suplementare. Te tilla Marreveshje mund te jene te aplikueshme per rajone te veØanta, per parazite te veØante, per bime dhe produkte bimore te veØanta, per metoda te veØanta nderkombetare te transportit te bimeve e produkteve bimore, ose perndryshe te shtohen kerkesat e kesaj Konvente.
2. ?do marreveshje e tille suplementare do te hyje ne fuqi per Ødo pale kontraktuese perkatese pas pranimit te kerkesave qe kane te bejne me marreveshjet suplementare perkatese.
3. Marreveshjet suplementare do te inkurajojne qelimin e Konventes dhe do te harmonizojne principet dhe parashikimet e Konventes, si edhe principet e transparences, te mosdiskriminimit dhe shmangies se kufizimeve te maskuara, veØanerisht ne tregtine nderkombetare.

NENI XVII

Ratifikimi dhe anetaresimi

1. Kjo marreveshje do te jete e hapur per t'u nenshkruar nga te gjitha shtetet qe prej 1 Maj 1952 dhe do te ratifikohet ne daten me te shpejte qe eshte e mundur. Instrumentet e ratifikimit do te depozitohen me Drejtorin e Pergjithshem te FAO-s, i cili do te jape njoftimin per daten e depozitimit te Ødo shteti nenshkruer.
2. Sa me shpejt qe kjo Konvente te hyje ne fuqi ne perputhje me nenin XXII ajo do te jete e hapur per t'u anetaresuar nga shtetet jo nenshkruese dhe organizatat anetare te FAO-s. Aderimi do te kryhet nga depozitimi i nje instrumenti te anetaresimit me Drejtorin e Pergjithshem te FAO, i cili do te njoftoje te gjitha palet kontraktuese.
3. Kur nje organizate anetare e FAO behet nje pale kontraktuese e kesaj Konvente, organizata anetare, ne perputhje me kerkesat e nenit II paragrafi 7 te Kushtetutes se FAO, do te njoftoje ne kohen e anetaresimit te saj te tilla modifikime ose sqarime per deklarimet e saj per kompetenca sipas nenit II paragrafi 5 te Kushtetutes se FAO, qe mund te jete e domosdoshme ne driten e pranimit te saj per kete Konvente. ?do pale kontraktuese e kesaj Konvente mundet, ne Ødo kohe, t'i kerkoje organizates anetare te FAO-s qe eshte pale kontraktuese e kesaj Konvente te siguroje informacion per secilen dhe si ndermjet organizates anetare dhe shteteve anetare te saj, eshte pergjegjese per venien ne jete te Ødo Øeshtje te veØante te mbuluar nga kjo Konvente. Organizata anetare do te parashikojte kete informacion brenda nje kohe te arsyeshme.

NENI XVIII

Palet jokontraktuese

Palet kontraktuese do te inkurajojne Ødo shtet ose organizate anetare te FAO-s, jo pale e kesaj Konvente te pranojne kete Konvente, dhe do te inkurajojne Ødo pale jo kontraktuese te zbatojne masat fitosanitare ne perputhje me parashikimet e kesaj Konvente dhe Ødo standard nderkombetar te miratuar ketu.

NENI XIX

Gjuhët

1. Gjuhët autentike të Konventës do të jenë gjuhët zyrtare të FAO-s.
2. Asgjë në këtë Konventë nuk do të hartohet si Ø kerkojnë Palet Kontraktuese për të siguruar dhe publikuar dokumentet ose për të siguruar kopjet e tyre në gjuhën (t) e ndryshme të paleve kontraktuese, përve Ø sa deklarohen në paragrafin 3 që vijon më poshtë.
3. Dokumentet që vijojnë do të jenë të paktën në një nga gjuhët zyrtare të FAO-s;
 - (a) informacioni i parashikuar sipas nenit IV paragrafi 4;
 - (b) shënime që japin të dhëna bibliografike mbi dokumentet e transmetuara në përputhje me nenin VII paragrafi 2(b);
 - (c) informacioni i parashikuar sipas nenit VII 2(b), (d), (i) dhe (j);
 - (d) shënime me të dhëna bibliografike dhe një përmbledhje të shkurtër të dokumenteve përkatës mbi informacionin e parashikuar në nenin VIII 1 (a);
 - (e) kërkesat për informacion nga pikat e takimit po aq sa përgjigjet për të tilla kërkesa, por pa përfshirë ndonjë dokument bashkëngjitur;
 - (f) Ødo dokument behet i pershtatshëm nga palet kontraktuese për mbledhjet e Komisionit.

NENI XX

Asistenca teknike

Palet kontraktuese bien dakord për të parashikuar asistencë teknike për palet kontraktuese, ve Øanerisht ato që janë pale kontraktuese në zhvillim, bilaterale ose përmes organizatave nderkombetare përkatëse, me objektivin për të lehtësuar venien në jetë të Konventës.

NENI XXI

Shtesat

1. Ødo propozim nga një pale kontraktuese për një shtesë në këtë Konventë do t'i komunikohet Drejtorit të Përgjithshëm të FAO.
2. Ødo shtesë e propozuar për këtë Konventë e marrë nga Drejtori i Përgjithshëm i FAO nga një pale kontraktuese do të paraqitet në një sesion të ve Øante të Komisionit për miratim dhe, nëse shtesa përfshin ndryshime teknike të rëndësishme ose imponon detyrime shtesë mbi palet kontraktuese, përpara Komisionit, ajo do të miratohet nga një komitet konsultativ i specialisteve të thirrur nga FAO.

3. Shenimet per Ødo shtese te propozuar per kete Konvente, te ndryshme nga shtesat ne Anekset, do t'u transmentohen paleve kontraktuese nga Drejtori i Pergjithshem i FAO jo me vone se dergimi i agendes se sesionit te Komisionit ne te cilin Øeshtja eshte miratuar.

4. Ødo shtese e tille e propozuar per kete Konvente do te kerkoje miratimin e Komisionit dhe do te hyje ne force 30 dite pas pranimit nga dy te tretat e paleve kontraktuese. Per qellimin e ketij neni, nje instrument i depozituar nga nje organizate anetare e FAO nuk do te llogaritet si e shtuar per ato te vendosura nga shtetet anetare te nje organizate te tille.

5. Shtesat perfshijne detyrime te reja per palet kontraktuese, megjithate, do te hyjne ne force perkatesisht per Ødo pale kontraktuese vetem pas pranimit prej saj dhe tridhjetete dite pas ketij pranimi. Instrumentat e pranimit te shtesave qe perfshijne detyrime te reja do te depozitohen nga Drejtori i Pergjithshem i FAO, i cili do te informoje te gjitha palet kontraktuese per marrjen e pranimit dhe hyrjen ne fuqi te shtesave.

6. Propozimet per shtesat per modelin e certifikates fitosanitare te dhene ne Aneksin e kesaj Konvente do te dergohen ne sekretari dhe do te konsiderohen per miratim nga Komisioni. Shtesat e miratuara per modelin e certifikates fitosanitare te vendosura ne aneksin e kesaj Konvente do te behen efektive nentedhjetete dit pas shpalljes se tyre per palet kontraktuese nga Sekretariati.

7. Per nje periudhe jo me shume se dymbedhjetete muaj nga nje shtese ne modelin e certifikates fitosanitare te vendosur ne Aneksin e kesaj Konvente qe nevojitet per ta bere ate efektive, do te jete gjithashtu legalisht i vlefshem versioni i meparsherm i certifikates fitosanitare per qellimin e kesaj Konvente.

NENI XXII

Hyrja ne fuqi

Sapo kjo Konvente te jete ratifikuar nga tre shtetet nenshkruese ajo do te hyje ne fuqi midis tyre. Ajo do te hyje ne fuqi per Ødo shtet ose organizate anetare te FAO te ratifikuar ose anetaresuar ketu nga data e depozitimit te instrumenteve te saj per ratifikim ose anetaresim.

NENI XXIII

Denoncimet

1. Ødo pale kontraktuese mundet ne Ødo kohe te jape njoftime per denoncimin e kesaj Konvente me njoftim te adresuar Drejtorit te Pergjithshem te FAO. Drejtori i Pergjithshem do te njoftoje menjehere te gjitha palet kontraktuese.

2. Denoncimi do te jete i efektshem nje vit nga data e marrjes se njoftimit nga Drejtori i Pergjithshem i FAO-s.

Model Phytosanitary Certificate
Modeli i Certifikates Fitosanitare

No.

Plant-Protection Organisation of _____
Organizata (t) e Mbrojtjes se Bimeve
To: Plant Protection Organisation (s)
Per: Organizaten (tat) e Mbrojtjes se Bimeve

I. Description of consignment
I. Pershkrimi i ngarkeses

Name and address of exporter
Emri dhe adresa e eksportuesit
Declared name and address of consignee
Emri dhe adresa e deklaruar e marresit te ngarkeses
Number and description of packages
Numri dhe pershkrimi i pakove
Distinguishing marks
Shenjat dalluese
Place of origin
Vendi origjines
Declared means of conveyance
Emri i deklaruar I
Declared point of entry
Pikat e hyrjes te deklaruar
Name of produce and quantity declared
Emri i prodhimit dhe sasia e deklaruar
Botanical name of plants
Emri botanik i bimes

This is certify that the plants or plant products described herein have been inspected and/ore tested according to appropriate official procedures and are considered to be free from the quarantine pests specified by the importing contracting party and to conform with the current phytosanitary requirements of the importing contracting party including those for regulated non-quarantine pests.

They are deemed to be practically free from other pests. *

Kjo verteton qe bimet, produktet bimore ose artikuj te tjere te kontrollueshem te pershkruar ketu jane inspektuar dhe/ose testuar ne perputhje me procedurat perkatese dhe jane konsideruar te pastra nga parazitet karantinore te specifikuar nga pala kontraktuese importuese dhe ne perputhje me kerkesat fitosanitare te pales kontraktuese importuese, perfshire ato per parazitet jo karantinore te kontrollueshem. Ato jane gjykuar praktikisht te pastra nga parazitet e tjere.

11 Additional declaration
Deklarime shtese

III. Disinfestation and/ore Disinfection Treatment
Trajtime dezinfestimi dhe/ose dezinfektimi

Date: _____ Treatment _____ Chemical (active ingredient)
Data _____ Trajtimi _____ Kimikati (lenda aktive)
Duration and temperature _____ Concentration
Zgjatja e temperatures _____ Perqendrimi

Additional information

Informacion shtese

Place of issue _____

Vendi i leshimit

(Stamp of Organisation)

Name of authorized officer

Vula e sherbimit

Emri dhe firma e inspektorit

Date _____

(Signature)

No financial liability with respect to this certificate shall attach to _____
(name of Plant Protection Organisation) or to any of its officers or representatives.*

Asnje detyrim financiar ne lidhje me kete certifikate nuk do t'i jepet _____
(emri i organizates se Mbrojtjes se Bimeve) ose ndonjerit prej oficereve ose perfaqesueve
te saj.

*Optional clause

Fjali fakultative

Model Phytosanitary Certificate for Re-Export

Modeli i Certifikates Fitosanitare per Ri-Eksport

No .

Plant Protection Organisation of _____ (contracting party of re-export)
Organizata (t) e Mbrojtjes se Bimeve (palet kontraktuese te ri-eksportit)

To: Plant Protection Organisation (s) _____ (contracting party of re-export)
Per: Organizaten (tat) e Mbrojtjes se Bimeve (palet kontraktuese te ri-eksportit)

I. Description of consignment

I.Pershkrimi i ngarkeses

Name and address of exporter

Emri dhe adresa e eksportuesit

Declared name and address of consignee

Emri dhe adresa e deklaruar e marresit te ngarkeses

Number and description of packages

Numri dhe pershkrimi i pakove

Distinguishing marks
Shenjat dalluese
Place of origin
Vendi i origjines
Declared means of conveyance
Emri i deklaruar i
Declared point of entry
Pikat e hyrjes te deklaruar
Name of produce and quantity declared
Emri i prodhimit dhe sasia e deklaruar
Botanical name of plants
Emri botanik i bimes

This is certify that the plants, plant products or other regulated articles described above _____ were imported into (contracting party of re-export) _____ from _____ (contracting party of origin) covered by Phytosanitary Certificate No.____,* original (), certified true copy () of which is attached to this certificate; that they are packed () repacked () in original () * new () containers, that based in the original phytosanitary certificate () and additional inspection (), they are considered to conform with the current phytosanitary requirements of the importing contracting party, and that during storage in _____ (contracting party of re-export) the consignment has not been subjected to the risk of infestation or infection.

*Insert tick in appropriate () boxes.

Kjo verteton qe bimet, produktet bimore ose artikuj te tjere te kontrollueshem te pershkruar me siper _____ jane importuar permes (pala kontraktuese per ri-eksport) _____ nga _____ (pala kontraktuese e origjines) te pajisura me Certifikate fitosanitare No.____, *kopja origjinale e vertetuar e sakte () e te ciles ishte bashkengjitur; qe ato jane paketuar () ripaketuar ne konteniere origjinale, dhe bazuar ne certifikaten fitosanitare origjinale () dhe inspektimin shtese () ato konsiderohen konform me kerkesat fitosanitare te vendit importues dhe qe gjate ruajtjes ne _____ (pala kontraktuese e ri-eksportit) ngarkesa nuk ishte subjekt i rrezikut per infestim ose infeksion.

II. Additional declaration

Deklarime shtese

III. Disinfestation and/or Disinfection Treatment

Trajtime dezinfestimi dhe/ose dezinfektimi

Date	Treatment	Chemical (active ingredient)
Data	Trajtimi	Kimikati (lenda aktive)

Duration and temperature	Concentration
Zgjatja e temperatures	Perqendrimi
Additional information	

Informacion shtese

Place of issue

Vendi i leshimit

(Stamp of Organisation)

Vula e Sherbimit

date

(Signature)

Name of authorized officer

Emri dhe firma e inspektorit

No financial liability with respect to this certificate shall attach to _____
(name of Plant Protection Organisation) or to any of its officers or representatives.*
Asnje detyrim financiar ne lidhje me kete certifikate nuk do t'i jepet _____
(emri i Organizates se Mbrojtjes se Bimeve) ose ndonjerit prej oficereve ose
perfaqesuesve te saj.

* Optional clause

Fjali fakultative